



Përforcuesi i COVID-19 Pyetje të bëra shpesh

A keni ndonjë pyetje për injektimin përforcues të COVID-19? Përgjigjet tuaja i gjeni më poshtë dhe mund të vizitoni edhe mass.gov/CovidVaccine

Përse duhet ta marrim përforcuesin COVID?

Vaksina COVID-19 ka efektivitet të lartë, por si shumë vaksina të tjera, për të siguruar mbrojtje maksimale me kalimin e kohës nevojitet një injektim përforcues. Përforcuesi i COVID-19 ofron mbrojtje shtesë nga virusi dhe variantet e tij. Marrja e përforcuesit rrit aftësinë e trupit tuaj për të luftuar virusin.

Cilët përforcues janë të disponueshëm sot?

Përforcuesit nga Pfizer, Moderna dhe Johnson & Johnson janë të disponueshme sot. Ata të gjithë janë të sigurt, efektivë dhe jepen falas.

Çfarë duhet të kemi me vete për të marrë përforcuesin?

Për marrjen e përforcuesit COVID nuk keni nevojë të keni me vete as ID, as sigurimin shëndetësor, dhe as kartën e vaksinimit. Megjithatë, pasja e me vete e kartës së sigurimit shëndetësor dhe e kartës së vaksinimit nga COVID-19 mund të ndihmojë në përshpejtimin e vizitës suaj.

A ka ardhur koha që edhe unë ta marr përforcuein?

Përforcuesit ofrojnë mbrojtjen më të mundshme ndaj COVID-19, dhe kushdo që kualifikohet duhet ta marrë përforcuesin e vet. Ju kualifikoheni që të merrni përforcuesin në qoftë se jeni në moshën 18 vjeç e lart dhe kanë kaluar 6 muaj nga koha kur keni marrë dozën e dytë Moderna; nëse jeni në moshën 16 vjeç e lart dhe kanë kaluar 6 muaj qysh kur keni marrë dozen e dytë Pfizer; ose kanë kaluar 2 muaj qysh nga doza juaj e vetme Johnson & Johnson.

Cilin përforcues duhet të zgjedh?

Të gjithë përforcuesit janë efektivë dhe bazohen në udhëzimet e CDC-së dhe FDA-së; ato mund të përzihen ose të përputhen. Po qe se keni pyetje për injektimin e përforcuesit atëherë mund të pyesni mjekun tuaj.



Mund të mësoni më shumë tek:
mass.gov/CovidVaccine

**Vaksina
shpëton
jetë**

